



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. regjistri (JR) 10/2018
Nr. 10/2 regj.

Tiranë, më 20.11.2018

SHPALLJE
E
NJOFTIMIT PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJES NË SEANCË PUBLIKE

Nëpërmjet kësaj shpallje, Kolegji i Posaçëm i Apelit, bazuar në nenin 65, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, njofton subjektet pjesëmarrëse në proces si dhe të gjithë personat e interesuar, se ditën e **mërkurrë**, në datën **12.12.2018**, ora **10:00**, do të gjykohet në seancë gjyqësore publike çështja me numër regjistri (JR) 10/2018, datë 31.07.2018, për ankimin që Komisioneri Publik ka bërë kundër vendimit nr. 24, datë 31.06.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit Bashkim Dedja.

Seanca gjyqësore publike do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” Nr. 3, Tiranë.

Trupi Gjyqësues, përbëhet nga gjyqtarët:

Kryesues i Trupit Gjyqësues	Ardian Hajdari
Relator i Çështjes	Luan Daci
Gjyqtare	Albana Shtylla
Gjyqtare	Natasha Mulaj
Gjyqtare	Rezarta Schuetz

Bazuar në nenin 460 pika 5 të Kodit të Procedurës Civile kjo shpallje bëhet të paktën 15 ditë para seancës së gjykimit, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe në ambientet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Ky njoftim bëhet gjithashtu edhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, si dhe në faqen e internetit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

RELATORI I ÇËSHTJES
GJYQTAR
Luan Daci

KRYESUESI I TRUPIT GJYKUES
GJYQTAR
Ardian Hajdari

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” Nr. 3, Tiranë, www.kpa.al, e-mail: info@kpa.al

